

**LIGJ**  
**Nr. 69/2024**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9587, DATË 20.7.2006,**  
**“PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 54 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Kudo në këtë nen fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit” zëvendësohen me fjalët “Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 2 të këtij neni jep dënimin kryesor me gjobë:

a) për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “ë” dhe “j” nga 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

b) për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “ç”, “e”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” nga 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë deri në 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Gjoha e vendosur në zbatim të këtij neni përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjoha paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbartimit sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.7.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 259, datë 24.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bajram Begaj.**